



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.10.2023

MBLEDHJA Nr. 54,
Datë 23.10.2023, ora 15:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 23.10.2023, ora 15:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 54 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.10.2023.
2. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”
3. Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “TEKSOEN 1”
4. Mbi licencimin e shoqërisë “GEALB ENERGY” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC GOJAN
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” shpk për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e asetëve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI